

# UDHËZUES PËR PACIENTËT



ACIBADEM | SISTINA

# BËHET FJALË PËR JETËN



ACIBADEM | SISTINA

# SPITALI KLINIK “ACIBADEM SISTINA”

Spitali klinik “Acibadem Sistina” është spitali më i madh dhe më modern në rajon dhe është shembull i një historie të suksesshme në sektorin shëndetësor me shërbime mjekësore sipas protokolleve më të reja në mjekimin e pacientëve. Ekipi cilësor mjekësor duke përdorur metoda dhe teknika moderne i'u qëndron në dispozicion pacientëve 24 orë në ditë, në 7 ditët e javës.

“Acibadem Sistina”, eko spitali i parë në vend, është i vendosur në një objekt ultra modern në sipërfaqe prej 26.700 m2. Arkitektura e spitalit është realizuar në pajtim me të gjitha standardet ndërkombëtare, ndërsa sistemi i sigurisë është në nivelin më të lartë.

Spitali është i shpërndarë në 11 kate me kapacitet prej 200 shtretërve, 105 dhoma spitali dhe 16 VIP apartamente. Në dispozicion të pacientëve janë edhe 62 shtretër intensiv spitalor dhe 74 vende për spital ditor. Komoditeti dhe kushtet në spital janë të adaptuara me ato të hoteleve me 5 yje.

Spitali klinik, “Acibadem Sistina” mori vulën e artë të cilësisë dhe sigurisë nga organizata më prestigjioze për akreditimin e spitaleve në mbarë botë. Vula e artë është dëshmi për cilësinë si rezultat i angazhimit të spitalit për të ofruar shërbim efikas dhe siguri për pacientët e tij. Akreditimi nga JCI paraqet siguri për çdo pacient, se në “Acibadem Sistina”, pacienti është i sigurt dhe se merr kujdesin më të mirë mjekësor.

Marka Sistina në shëndetësinë maqedonase filloi në vitin 2001, me spitalin e parë në fushën e gjinekologjisë dhe obstetrikës. 10 vjet më vonë filloi ta zgjerojë veprimtarinë e vet me hapjen e spitalit të parë privat klinik në vend. Zhvillimi i “Sistina” nuk mbeti këtu.

Nga nëntori i vitit 2010 u nënshkrua marrëveshje për afilacion me zinxhirin më të madh dhe më bashkëkohor të spitaleve në Evropën Juglindore “Acibadem”. Marrëveshja krijoi mundësi për shkëmbim të njohurive, përvojave dhe edukimit me ekipin mjekësor të gjigandit shëndetësor turk. Vetëm për një vit ky bashkëpunim i suksesshëm u rrit në partneritet të përbashkët. Spitali klinik “Sistina” u bë pjesë e Grupacionit shëndetësor “Acibadem” dhe spitali i parë i këtij lideri në shëndetësi jashtë kufijve të Turqisë.

“Acibadem Sistina” sot është pjesë e zinxhirit të dytë më të madh të spitaleve, grupacioni nga Malajzia, Integrat-ed Healthcare Holdings (IHH). Hyrja në këtë grupacion e vendosi Maqedoninë në hartën botërore shëndetësore.

Spitali klinik “Acibadem Sistina” si institucion më modern shëndetësor në vend do të vazhdojë të investojë në kuadrin e tij dhe teknologjinë mjekësor me qëllim për ta ofruar kujdesin më të mirë shëndetësor për pacientët e tij.

**Shëndeti është pasuria më e madhe, na lejoni që të kujdesemi për shëndetin tuaj.**

# UDHËZUES PËR INFORMIMIN E PACIENTËVE

Vendosja e komunikimit të mirë mes pacientit dhe mjekut është me rëndësi të madhe për ndërtimin e besimit dhe ndikon pozitivisht mbi procesin e mjekimit.

Mjeku dhe pacienti së bashki marrin vendimin për procesin e mjekimit. Kjo qasje është e dobishme edhe për mjekun edhe për pacientit, pasi mundëson përfshirje aktive të pacientit në procesin e mjekimit.

Profesionistët shëndetësorë duhet vazhdimisht t'i informojnë pacientët për gjendjen e tyre klinike, t'iu rekomandojnë metodat e diagnozës, t'iu sqarojnë rreziqet dhe komplikimet e mundshme, si dhe mundësitë për mjekim.

Mjeku dhe pacientë së bashku duhet ta sjellin vendimin për procesin e mjekimit. Kjo qasje është e dobishme edhe për mjekun edhe për pacientit, pasi mundëson përfshirje aktive të pacientit.

Pacienti ka të drejtën ta pyesë mjekun në lidhje me sëmundjen. Në këtë mënyrë pacienti do të informohet mirë për sëmundjen e tij dhe ashtu do të marrë pjesë në procesin e mjekimit.

## **Pacientët e informuar kontribuojnë për gabimet më të vogla mjekësore**

Gabimet mjekësore shpesh janë si pasojë e komunikimit të pamjaftueshëm mes mjekut dhe pacientit, informimi i pamjaftueshëm nga ana e pacientëve lidhur me sëmundjen dhe pasiviteti i tyre në procesin e mjekimit.

Prandaj shumë e rëndësishme është që pacientët në mënyrë aktive të përfshihen në procesin e vendimmarrjes, të jenë aktiv në mjekimin e tyre, të jenë të informuar për problemet e tyre mjekësore dhe të kenë komunikim të mirë në raportin pacient-mjek-infermiere.

## **Pengimi i rrëzimeve**

Natyrisht se mjedisi në spital nuk i ngjan mjedisit të shtëpisë suaj. Prandaj funksionimi në këto dy mjedise ka karakteristika të ndryshme.

Ilaçet që i merrni gjatë qëndrimit tuaj në spital, si dhe disa procedura terapeutike mund të ndikojnë mbi mos ekuilibrin e trupit dhe të jenë shkak i rrëzimeve.

Prandaj Ju lutemi që për shkak të sigurisë Tuaj, të gjitha ilaçet që i merrni si terapi të rregullt, të rekomanduara nga mjeku i familjes ose nga ndonjë mjek tjetër specialist, t'i paraqitni te mjeku Juaj në spitalin tonë.

Ju lutemi që t'i ndërmerreni masat e kujdesit që vijojnë gjatë qëndrimit tuaj në spital:

- Sigurohuni që sistemi për thirrjen e infermieres dhe të gjitha gjërat tuaja personale, të cilat i keni të domosdoshme për funksionim tuaj normal të vendosen në vend adekuat. Nëse diçka nga këto ju mungon, kërkoni ndihmë nga infermierja ose nga ndonjë i punësuar tjetër që ndodhet pranë për momentin.
- Nivelin e lartësisë në të cilën është vendosur shtrati në dhomën e spitalit mos e ndërroni vetë. Kërkoni ndihmë nga infermierja.

- Shihni nëse ndriçimi është i mirë dhe nëse papuçet të cilat mbathni nuk rrëshqasin kur lëvizni nëpër spital.
- Nëse keni nevojë për ndihmë që të ngriheni nga shtrati, informoni infermierin.
- Nëse keni marramendje gjatë ngritjes nga shtrati, qëndroni në pozitë të shtrirë për disa minuta. Nëse marramendja nuk zhduket, kërkoni ndihmë nga infermierja.
- Nëse janë vendosur gjëra që e pengojnë lëvizjen Tuaj dhe të cilat mund të shkaktojnë rrëzim, kërkoni që të njëjtat të hiqen.
- Nëse keni nevojë për ndihmë gjatë lëvizjes ose keni nevojë për përdorimin e ndihmesave mjekësore për lëvizje, menjëherë lajmëroni infermierin.
- Informohuni për mënyrën e përdorimit të gjërave që përdoren në aktivitetet e përditshme (larja, të ushqyerit, pirja, veshja).
- Para se të laheni konsultohuni me infermierin dhe respektoni instruksionet të cilat ajo do t'ju japë. Nëse keni nevojë për ndihmë gjatë larjes, informoni infermierin.

# PARASHTRONI MJEKUT TUAJ PYETJET QË VIJOJNË:

Disa nga pyetjet të cilat duhet t'ia parashtroni mjekut tuaj, me qëllim që të vendosni raport dhe bashkëpunim të shëndoshë:

## **Për ankesat tuaja ose për shëndetin tuaj**

- Cila është diagnoza ime?
- Cili është shkaku i kësaj gjendje?
- Ankesat/sëmundja ime a mund të shërohet?
- A ekzistojnë simptoma të caktuara të cilat duhet t'i vërej dhe t'ju informoj në rast se ato paraqiten?
- A duhet të ndryshoj diçka në mënyrën time të jetës, si për shembull, zakone apo veprime?

## **Për ekzaminimet:**

- Cili është përfundimi në bazë të rezultateve nga ekzaminimet që i propozuat?
- Kur do të jenë gati rezultatet?
- Ndaj çfarë duhet të kujdesem para kryerjes së ekzaminimit?
- Disa nga ekzaminimet a mund të jenë të dëmshme për mua?

## **Për mjekimin:**

- A janë gati rezultatet e ekzaminimeve të kryera?
- Cila është procedura për mjekimin e kësaj gjendjeje?
- Sa zgjatë mjekimi?
- Cilat janë shanset për sukses nga mjekimi?
- Cilat janë rreziqet potenciale dhe pasojat e padëshiruara lidhur me këtë mjekim?
- A ekziston ushqim, ilaçe ose aktivitete të caktuara të cilave duhet t'u shmangem gjatë mjekimit?
- Për momentin marr disa ilaçe të tjera për probleme të tjera shëndetësore. A do të kenë ndikim negativ mbi mjekimin tim nëse vazhdoj t'i marr?
- Pirja e cigares dhe konsumimi i alkoolit a kanë ndikim të caktuar?
- Çfarë do të ndodhë nëse bëj gabim gjatë aplikimit të ilaçeve të cilat Ju mi keni shkruar?
- A ekzistojnë mundësi alternative për mjekim për të cilat duhet të informohem?
- A ekzistojnë mundësi më të mira për mjekim të cilat nuk mund të arrihen në spitalin tuaj, por ekzistojnë në spitale të tjera?

# INFORMATATA PËR SPITALIN







# MIRËSERDHËT NË SPITALIN KLINIK “ACIBADEM SISTINA”

Ky doracak për pacientët është përgatitur me qëllim që t'ju lehtësojë qëndrimin në spitalin tonë. Në këtë manual janë sqaruar të drejtat tuaja, por edhe obligimet gjatë mjekimit.

Spitali ynë disponon me teknologji bashkëkohore dhe moderne, me ekip cilësor të specialistëve të njohur në vend dhe rajon. Qëllimi dhe misioni ynë është T'ju sigurojmë shërbim të bazuar në besim, siguri dhe kualitet në nivel më të lartë.

Arkitektura moderne e spitalit tonë mundëson funksionim maksimal. Të gjitha repartet janë të lidhura mes tyre, duke mundësuar diagnozën dhe trajtimin e pacientëve në intervalin më të shkurtër kohor.

Sallat e operacionit dhe njësitë për kujdes intensiv janë ndërtuar sipas protokolleve botërore, ndërsa në dhomat e pajisura moderne të spitalit dhe apartamentet ofrojmë komoditet dhe ambient të këndshëm.

Me angazhimin tonë të vazhdueshëm për shëndetësi cilësore dhe moderne i ngritëm standardet për kujdes shëndetësor në vend. U bëmë lider në rajon, ndërsa pacientët e njohën kualitetin tonë. U bëmë spital ku prioriteti është shëndeti dhe jeta e pacientit.

Për shëndetin më të rëndësishme janë dituria dhe përvoja pasiqë

**BËHET FJALË PËR JETËN**

Me respekt,

**Spitali klinik “Acibadem Sistina”**

<p><b>QENDRA EMERGJENTE</b></p>	<p>Ekipi mjekësor nga qendra jonë urgjente, e cila punon 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë është e përgatitur që në kohë t'u përgjigjet të gjitha nevojave tuaja shëndetësore.</p>
<p><b>SHËRBIME AMBULATORE</b></p>	<p>Ju lutemi që ta informoni infermierën nëse keni nevojë për shërbime plotësuese ambulatorë në spitalin tonë.</p>
<p><b>FLETAT ANKETUESE</b></p>	<p>Ju lutemi që të plotësoni fletën anketuese, të cilën do ta gjeni në dhomën tuaj që të na informoni për reko- mandimet dhe sugjerimet tuaja, si dhe të na informoni për ndjesinë tuaj gjatë qëndrimit në spitalin tonë. Fletën anketuese do ta marrim nga ana e këshilltarit për mbrojtjen e të drejtave të pacientit. Rezultatet e fituara nga fleta anketuese kanë rëndësi të veçantë për ne dhe do të na ndihmojnë në përpjekjet për t'ju siguruar shërbime më të mira gjatë qëndrimit tuaj në spital.</p>
<p><b>TELEFONAT CELULARE</b></p>	<p>Gjatë qëndrimit Tuaj në spital, Ju lutemi që t'i fikni telefonat celular ose lëreni zilen e telefonit tuaj pa zë, që të mund të zhvillohen pa pengesa kontrolli mjekësor dhe ndërhyrjet. Atmosferën e qetë në spital është shumë e rëndësishme për çdo pacient.</p>
<p><b>(CALL) QENDRA PËR THIRRJE</b></p>	<p>Qendra jonë telefonike ju qëndron në dispozicion për caktimin e kontrolleve dhe intervenimeve në spitalin tonë. Gjithashtu, të punësuarit në qendrën telefonike do t'ju përgjigjen të gjitha e-maileve tuaja të dërguara për caktimin e terminëve ose do t'ju japin informata lidhur me përgatitjen tuaj para intervenimit radiologjik ose endoskopik.</p>
<p><b>PËRKTHYESI</b></p>	<p>Për nevojat e komunikimit në gjuhë të huaj, SK "Acibadem Sistina" ju siguron shërbime nga përkthyesit tanë. Të punësuarit nga sektori për marrëdhënie me pacientët do t'ju ndihmojnë lidhur me këtë çështje.</p>

<b>LULET</b>	<p>Në katet ku janë vendosur pacientët nuk pranohen lule për shkak të rrezikut të shfaqjes së alergjive. Nëse dikush do t'ju dërgojë lule gjatë qëndrimit tuaj në spital, ato do të pranohen nga personeli i recepcionit administrativ dhe do t'ju dorëzohen juve ditën që do të largoheni nga spitali. Ju lutemi për këtë të drejtoheni në recepcionin pranues administrativ.</p>
<b>SHËRBIME NUTRICIONISTE</b>	<p>Nutricionisti ynë, nëse keni nevojë, në konsultim me mjekun tuaj ordinar do të përpilojë regjim të veçantë të ushqimit për Ju, në bazë të gjendjes suaj shëndetësore dhe trajtimit të nevojshëm mjekësor.</p>
<b>APARATET ELEKTRIKE</b>	<p>Ju lutemi që mos t'i vini në punë aparatet elektrike me konsum të madh të energjisë elektrike në dhomën tuaj për shkak të ndonjë rreziku të mundshëm apo defekt teknik.</p>
<b>KAFSHËT SHTËPIAKE</b>	<p>Nuk lejohet futja e kafshëve shtëpiake në spital.</p>
<b>GAZETA DHE REVISTA</b>	<p>Revista „Acibadem Sistina PLUS“ është në dispozicion në spitalin tonë dhe mund ta merrni në çdo kohë. Për shkak të covidit dhe masave të sigurisë, të gjitha revistat dhe gazetat e jashtme janë tërhequr.</p>
<b>KËSHILLTARËT PËR MBROJTJE TË DREJTAVE TË PACIENTËVE</b>	<p>Këshilltarët tanë për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve do t'ju takojnë dhe do t'i dëgjojnë vërejtjet dhe sugjerimet tuaja dhe në kohë do t'ju informojnë për kërkesat tuaja. Mendimet dhe sugjerimet tuaja janë shumë të rëndësishme për përmirësimin e shërbimeve të cilat ofrohen në spitalin tonë.</p>
<b>SISTEMI PËR NGROHJE DHE FTOHJE</b>	<p>Sistemi për ngrohje dhe ftohje kontrollohet në nivel lokal në dhomën tuaj të spitalit dhe komandimi i tij bëhet nga infermierja. Nëse keni problem me sistemin, vëreni në dijeni infermierën e cila do të informojë shërbimin teknik në mënyrë që t'a zgjidhin këtë problem për një afat kohorë sa më të shkurtër.</p>

<p><b>INFERMIERET</b></p>	<p>Gjatë qëndrimit tuaj në spital mund të merrni kujdes nga infermierja sa herë që të keni nevojë.</p> <p><b>INFERMIERJA PERSONALE</b></p> <p>Nëse dëshironi që të keni infermiere e cila do të qëndrojë me ju 24 orë, SK “Acibadem Sistina” do t’ju mundësojë këtë, por për të njëjtën paguhet në mënyrë plotësuese. Për këtë Ju lutemi që ta kontaktoni infermieren përgjegjëse në repartin ku jeni vendosur.</p> <p><b>SISTEMI PËR THIRRJEN E INFERMIERES</b></p> <p>Infermierët do t’ju qëndrojnë në dispozicion sa herë që keni nevojë për shërbimin e tyre. Sistemi për thirrjen e infermieres gjendet në anë të shtratit tuaj dhe të njëjtin mund ta përdorni gjithmonë kur do të keni nevojë për prezencën e saj. Ajo do të arrijë në dhomën tuaj në afatin më të shkurtër kohor.</p>
<p><b>SHËRBIMET FETARE</b></p>	<p>Në spitalin tonë Ju qëndrojnë në dispozicion vende për kryerjen e nevojave fetare. Spitalit disponon kishë dhe dhomë për lutje që ju qëndron vazhdimisht në dispozicion.</p>
<p><b>INTERNETI</b></p>	<p>Në të gjithë spitalin në dispozicion ka internet rrejt pa tel falas.</p>
<p><b>SENDET PERSONALE</b></p>	<p>Gjatë pranimit në spital, sendet tuaja personale paraqitni te infermierja e cila ju pranon. Të gjitha sendet Tuaja personale do të ruhen në pajtim me procedurën e spitalit. Informacion për këtë do t’ju japë infermierja e cila do të bëjë pranimin tuaj në spital.</p>
<p><b>SHËRBIMET PËR MIRËMBAJTJE</b></p>	<p>Personeli ynë për mirëmbajtjen e higjienës kujdeset për dhomën Tuaj dhe rrethinën që vazhdimisht të jenë të pastra.</p>

<b>SHËRBIMET E FLOKTARISË</b>	Në spitalin mund të përdorimin shërbimet e parukerisë që paguhen shtesë, vetëm janë falas për gratë shtatzëna në Departamentin e gjinekologjisë dhe obstetrikës.
<b>MASAZHI</b>	Gjatë qëndrimit Tuaj në spital mund të shfrytëzoni masazh relaksues që paguhet në mënyrë plotësuese. Për këtë informohuni te infermierja juaj.
<b>SHËRBIME PLOTËSUESE</b>	Spitali klinik “Acibadem Sistina” Ju qëndron në dispozicion për të gjitha nevojat tuaja zyrtare si faks, telefon, internet, kompjuter, fotokopje etj. Punonjësi administrativ do t’ju informojë si t’i arrini këto shërbime.
<b>PAGESA</b>	<p>Për çfarëdo pagesa të parakohshme të cilat janë cekur para pranimit tuaj, mund të paguhet në repartin për pagesë. Gjatë qëndrimit tuaj, personeli i repartit për pagesë do t’ju informojë për gjendjen e fundit të shpenzimeve tuaja për mjekim dhe mënyrën e pagesës. Në rast të hospitalizimit më të gjatë, do të duhet të paguani paradhënie për shpenzimet tuaja për mjekim. Për shpenzimet për mjekim mund të paguani me të holla të gatshme ose me kartelë kreditore.</p> <p>Nëse keni euro ose deviza tjera, të njëjtat mund t’i ndërroni në denarë në bankën që është në kuadër të spitalit.</p>
<b>SHOQËRIMI NË DHOMË</b>	Shtrat më vete dhe meny standarde për ushqim disponon edhe shoqëruesi. Çdo person i cili viziton pacientin pas orës 22:00 konsiderohet si shoqërues. Çdo pacient ka të drejtë për një shoqërues të vetëm në dhomën spitalore (kjo sipas dëshirës së pacientit). Për çdo shoqërues kryhet pagesë shtesë.
<b>QETËSIA</b>	Gatishmëria juaj që të sigurohet ambient i qetë në spital do të ndihmojë në procesin e mjekimit të pacientëve.

<b>PIRJA E DUHANIT</b>	Pirja e duhanit është e ndaluar në spitalin tonë.
<b>PËRDORIMI I UJIT</b>	Personeli i cili e sjell ushqimin në dhomën tuaj ju furnizon me ujë për pije në shishe. Gjithashtu mund t'i përdorni edhe aparatet për ujë të cilat gjenden në katin ku jeni vendosur.
<b>PROCEDURA PËR ÇREGJISTRIM</b>	Procedura juaj për çregjistrim do të iniciohet nga ana e mjekut tuaj dhe punëtorit administrativ, të cilët do t'ju informojnë për gjithë procesin e punës.
<b>TELEFONI</b>	Telefoni i cili është gjithnjë i disponueshëm ndodhet në dhomën e stacionarit për obstetrikë, mund ta përdorni për të lajmëruar infermieren e cila kujdeset për foshnjën tuaj. Linja telefonike është drejtpërdrejt e lidhur me lokalin e infermieres në repartin e neonatologjisë.
<b>TELEVIZIONI</b>	Nëse keni problem me përdorimin e telekomanduesit, kërkoni ndihmë nga personeli i cili është i disponueshëm për momentin. Ju lutemi që volumi i televizorit të jetë i vendosur në heshtje, që mos t'i shqetësoni pacientët tjerë.

## KANALET TELEVIZIVE

Numri i kanalit	Kanali TV	Numri i kanalit	Kanali TV	Numri i kanalit	Kanali TV
1	TVM 1	15	ERA-SK (D1-SK)	29	Eurosport
2	Sitel	16	Hayat Plus	30	Eurosport 2
3	Kanal 5	17	Vizion Plus	31	Arena 4
4	Telma	18	News 7	32	Sport Klub 1
5	Alfa TV	19	RTV 21	33	FOX
6	Arena 1	20	Luxe TV	34	TV 1000
7	Sport Klub 2	21	RTS	35	AXN
8	Kanal 5+	22	Arena 3	36	FLN
9	Sitel 3	23	National Geographic	37	Fashion TV
10	24Vesti	24	Discovery Channel	38	CNN
11	Al Jazeera	25	Animal Planet	39	Sport Klub 3
12	TVM 2	26	Arena 2	40	Deutsche Welle
13	Alsat M	27	Orlando Kids	41	Info kanal i Acibadem Sistina
14	Kanali i kuvendit	28	Boomerang		

<b>SHËRBIMI TEKNIK</b>	Shërbimi ynë teknik është në dispozicion 24 orë në ditë që të kujdesin e çdo defekti të pajisjeve.
<b>TRANSPORTI</b>	Punonjësi ynë administrativ do t'ju ndihmojë të thirrni taksi, nëse ju nevojitet.
<b>TRANSPORTI MJEKËSOR</b>	Transporti mjekësor bëhet me kërkesën tuaj në konsultim me mjekun. Automjetet tona mjekësore janë në gjendje për çfarëdolloj transporti mjekësor duke përfshirë edhe (të pacientët e sëmurë kritik dhe foshnjat).
<b>SHUJTA</b>	<p>Në Spitalin klinik “Acibadem Sistina” vlerësimin nutricionistik të pacientit e bënë mjeku ordinues, i cili në pajtim me diagnozën e vendosur dhe gjendjen momentale shëndetësore Ju shkruan një nga tre dietat fikse: standarde, kardiologjike dhe dieta diabetike. Për secilën prej këtyre tre dietave ekziston varianti i vaktit vegjetarian.</p> <p>Nëse mjeku ordinues mendon se për pacient të caktuar të hospitalizuar nevojitet dietë speciale, e njëjta do të përgatitet në bashkëpunim me nutricionistin, në pajtim me nevojat ushqyese ditore të pacientit.</p> <p><b>VAKTET SHËRBEHEN NË KËTO PERIUDHAKOHORE:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mëngjesi (ora 08.00-08.30)</li> <li>• Dreka (ora 12.30-13.00)</li> <li>• Darka (ora 18.00-18.30)</li> </ul> <p><b>VAKTET E FRUTAVE SHËRBEHET NË KËTO PERIUDHA KOHORE:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vakti I (10.00-10.30)</li> <li>• Vakti II (14.30- 15.00)</li> <li>• Vakti III (19.30-20.00)</li> </ul>



# TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PACIENTËVE DHE FAMILJARËVE TË TYRE



# TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PACIENTËVE DHE FAMILJARËVE TË TYRE

- Pacientët kanë të drejtë për kujdes dhe trajtim mjekësor cilësor, pa marrë parasysh racën, ngjyrën e lëkurës, besimin, handicapin, përcaktimin seksual dhe gjendjen ekonomike sociale;
- Pacientët kanë të drejtë të informohen për gjendjen shëndetësore, intervenimet e rekomanduara mjekësore, për rrjedhën, procedurën dhe rreziqet e mundshme gjatë realizimit të njëjtave;
- Pacientët gjithmonë kanë të drejtë të kërkojnë mendim profesional;
- Pacientët kanë të drejtë për kujdes në kohë dhe adekuat mjekësor kur kanë/ndjejnë dhimbje.
- Pacientët janë të obliguar që të veprojnë sipas këshillave të punonjësve shëndetësor për kujdes, trajtim dhe rehabilitim dhe të kujdesen për shëndetin e tyre.
- Pacientët janë të obliguar të pranojnë angazhim nëse i njëjti është pjesë e rehabilitimit dhe risocial-izimit në funksion të riaktivizimit të shkathësive sociale, si dhe në mënyrë aktive të bashkëpunojë me punëtorët shëndetësor.
- Si pacientë duhet të respektoni dinjitetin profesional dhe njerëzor të punonjësve shëndetësor dhe gjithë personelit në spitalin tonë, si dhe të pacientëve të tjerë.
- Personeli mjekësor i spitalit është i përgatitur të ofrojë kujdes të veçantë pacientëve terminal në momentet e fundit të jetës;
- Pacientët kanë të drejtë të informohen për emrin dhe mbiemrin e personelit që kujdeset për ata, për përgatitjen e tyre profesionale dhe titullin në spital;
- Pacientët janë të obliguar të japin të dhëna të sakta për identitetin e tyre, adresën e banimit dhe gjendjen shëndetësore, si dhe të paraqesin çdo ndryshim të dhënave personale.
- Pacientët kanë të drejtë për mbrojtje të dhënave të tyre personale, në pajtim me ligjin. Të gjitha intervenimet e pacientit realizohen në prezencë të personave që janë të domosdoshëm për realizimin e të njëjtave.
- Pacientët kanë të drejtë për qasje në dosjen mjekësore dhe kanë të drejtë të marrin kopje të dhënave/ dokumentet nga dosja.
- Pacientët kanë të drejtë ta braktisin spitalin me kërkesë të tyre me shkrim, përveç në raste kur kjo do të ishte e dëmshme për sigurinë dhe shëndetin e pacientit ose për sigurinë dhe shëndetin e personave tjerë.
- Pacientët dhe familjet e tyre kanë të drejtë të pranojnë/refuzojnë shërbim të caktuar mjekësor, përveç në rastet kur kjo do ta rrezikonte shëndetin e tyre dhe shëndetin e personave tjerë.

- Pa pëlqim me shkrim, pacientët nuk mund të përfshihen në mësimin mjekësor dhe hulumtimet shkencore klinike;
- Spitali klinik “Acibadem Sistina” i respekton përcaktimet shpirtërore dhe fetare të pacientëve;
- Të gjithë pacientët kanë të drejtë të marrin llogari për shërbimet e kryera mjekësore dhe obligim për të shlyer llogarinë financiare para largimit nga spitali;
- Pacientët kanë të drejtë të mbrohen nga sulmet fizike gjatë qëndrimit në spital;
- Në Spitalin klinik “Acibadem Sistina” ekzistojnë këshilltarë për mbrojtje të drejtave të pacientëve, me të cilat pacientët kanë të drejtë të konsultohen dhe të marrin këshilla dhe ndihmë juridike në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave si pacient;
- Gjatë qëndrimit në Spitalin Klinik “Acibadem Sistina” pacientët janë të obliguar që ta respektojnë Rendin shtëpiak në spital i cili u jepet që ta lexojnë dhe ta nënshkruajnë gjatë pranimit në spitalin tonë.

call center  
((02 3099 500))

[www.acibademsistina.mk](http://www.acibademsistina.mk)